



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 07, datë 07/02/2020

MBI

**“MIRATIMIN E PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS  
“SKENOGRAFI & KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI”, TË PARAQITUR  
NGA DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOREOGRAFI PRANË FAKULTETIT TË  
ARTIT SKENIK**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 79 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”, VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019), pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga F.A.S., pasi i diskutoi me votim të hapur unanimisht,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të Doktoratës “Skenografi & Kostumografi dhe Koreografi”, të paraqitur nga Departamenti Skenografi-Koreografi pranë Fakultetit të Artit Skenik, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim ti dërgohet për miratim paraprak Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve dhe më pas të përcillet në MASR për miratim përfundimtar, sipas Pikës 4, Kreut VI të Udhëzimit nr. 1, datë 14/01/2020 nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë Skenografi-Koreografi.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Asoc. Gene MULLIQI

Urim ALIAJ

Rajmond PRENDUSHI

